

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË LEZHË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Lezhë, me objekt “Për vlerësimin e performancës mbi mjedisin urban, prirjet dhe tendencat në qytetin e Lezhës” për periudhën 01.01.2010 deri më datë 31.12.2011, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 114 datë 30.06.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 467/6 datë 30.06.2012, dërguar Z [REDAKTUAR], Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në strukturën e Bashkisë së Lezhës të krijohet një drejtori apo sektor specifik që të merret me fushën e gjerë të mjedisit dhe problematikën e tij në qytetin e Lezhës dhe që të jetë realisht i angazhuar në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në qytet, trajtuar në faqet 10 - 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

2. Në Rregulloren e Brendshme të përcaktohen në mënyrë specifike dhe të hollësishme përgjegjësitë dhe detyrat e çdo sektori dhe punonjësi në fushën e planifikimit, menaxhimit, kontrollit të mjedisit urban, trajtuar në faqet 10 - 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

3. Bashkia Lezhë të zbërthejë në mënyrë të detajuar në plane veprimi, strategjitë e hartuara për problemet mjedisore nga strukturat organizative të bashkisë si dhe të marrë në analizë problemet mjedisore për qytetin e Lezhës, trajtuar në faqet 10 - 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

4. Drejtorja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Lezhë, duke qenë se ka përgjegjësinë kryesore për të patur një mjedis sa më të shëndetshëm në shërbim të qytetarëve, të hartojë planet vjetore të veprimit sipas detyrave përkatëse dhe të kryejë analiza periodike dhe vjetore mbi situatën mjedisore për qytetin e Lezhës, ku mbi bazën e të cilave të programohet puna për përmirësimin e situatës, trajtuar në faqet 10 - 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

5. Për kontrollet e ushtruara bazuar në njësinë territoriale për gjendjen e përbërësve të veçantë të mjedisit, në mbështetje të akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e organeve përkatëse në bashkëpunim me ARM Qarku Lezhë të mbahen akt kontrolle, akt verifikime apo procesverbale mbështetur në ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar me ligjin nr. 9890, datë 20.03.2008, neni 60, pika 2, trajtuar në faqet 10 - 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

6. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë të punojë për rritjen e performancës së arkëtimit dhe vjeljes së tarifës së pastrimit duke synuar realizimin e planifikimit vjetor si dhe rritjen e performancës së punës së kësaj drejtorie në përgjithësi, trajtuar në faqet 18 - 21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

7. Bashkia Lezhë të gjejë dhe të zbatojë mekanizmat e duhur ligjorë për vjeljen e tarifës së pastrimit dhe të gjelbërimit nga subjektet familjare, publike e private, trajtuar në faqet 18 - 21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

8. Bashkia Lezhë të hartojë dhe miratojë Rregulloren për administrimin mjedisor të mbetjeve urbane si dhe të mbetjeve të tjera të ngurta (speciale dhe të rrezikshme) që gjenerohen nga subjektet në qytetin e Lezhës, trajtuar në faqet 21 - 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

9. Bashkia Lezhë të identifikojë sasinë dhe tipologjinë e mbetjeve të ngurta urbane, atyre speciale dhe të rrezikshme që gjenerohen nga aktivitetet dhe të përcaktojë venddepozitimin përfundimtar të mbetjeve speciale dhe atyre të rrezikshme, trajtuar në faqet 21 - 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

10. Bashkia Lezhë të përfshijë në shërbimin e pastrimit, grumbullimit e transportit mbetjet urbane të gjeneruara në zonat e banuara në periferi të qytetit si dhe në ato informale, trajtuar në faqet 21 - 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

11. Bashkia të pasqyrojë dhe analizojë impaktin social, ekonomik e mjedisor për mbetjet që grumbullohen e depozitohen në mënyrë të diferencuar, sipas tipologjisë së tyre, trajtuar në faqet 21 - 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

12. Bashkia Lezhë të monitorojë kontratën e shërbimit të pastrimit të qytetit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, trajtuar në faqet 21 - 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

13. Bashkia Lezhë të hartojë një plan masash për përmirësimin e ajrit në qytet duke bashkëpunuar dhe me institucionet e tjera shtetërore (inspektorate) të cilat përgjigjen për cilësinë e ajrit, trajtuar në faqet 31 - 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

14. Bashkia Lezhë në bashkëpunim me ARM të kryejë monitorime dhe të hartojë të dhëna në lidhje me shfaqjen e smogut në qytetin e Lezhës, nëse ka shfaqje të tij gjatë vitit dhe në cilat periudha vërehet më shumë, trajtuar në faqet 31 - 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

15. Bashkia të bëjë përpjekje nga ana e saj në mënyrë që të përfshihet në listën e qyteteve të cilat monitorohen nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve për llogari të MMPAU, në lidhje me cilësinë e ajrit në këtë qytet, trajtuar në faqet 31 - 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

16. Bashkia t'i kërkojë organeve të kontrollit nën varësinë e saj të ushtrojnë kontroll, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo të mbyllin veprimtari që nuk respektojnë dispozitat e ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007, trajtuar në faqet 34 - 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

17. Bashkia Lezhë në bashkëpunim me ARM të drejtojë dhe zbatojë plane vendore të veprimit për zhurmën, të cilat të miratohen nga Këshilli Bashkiak, të drejtojë procesin e hartëzimit të zhurmës si dhe të marrë masa për të shpallur zona të qeta në mjedise të banuara apo mjedise të hapura, duke vendosur kufizime për zhurmën, trajtuar në faqet 34 - 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

18. Bashkia Lezhë të kërkojë nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që lëshojnë zhurmë, marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës, trajtuar në faqet 34 - 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

19. Bashkia Lezhë të kryejë studime afatshkurtër apo afatgjatë për shtimin dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbërta urbane ku të përcaktohen objektiva për rritjen e sipërfaqes në m² për banor, trajtuar në faqet 36 - 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

20. Bashkia Lezhë të kryejë studimin mbi zhvillimin e bimësisë urbane qoftë atë vertikale apo horizontale që përshtatet me kushtet ekologjike të këtij qyteti dhe të zbatojë këtë studim, trajtuar në faqet 36 - 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

21. Bashkia Lezhë të evidentojë sipërfaqen e gjelbërt pronë private rreth banesave si dhe sipërfaqeve të gjelbra në institucionet shtetërore që nuk janë në varësi të bashkisë, trajtuar në faqet 36 - 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

22. Të hartohet rregullorja dhe standardet për administrimin e sipërfaqeve të gjelbra urbane pronë publike e private, trajtuar në faqet 36 - 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

23. Bashkia Lezhë të bëjë klasifikimin e gjelbërimit urban sipas tipologjisë dhe funksionit të tyre në sipërfaqen prej 90561 m², trajtuar në faqet 36 - 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

24. Të monitorohet zbatimi i kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbëruara në përputhje me pikën II/14 neni 65 i Rregullores së Brendshme të Administratës së Bashkisë Lezhë, trajtuar në faqet 36 - 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

25. Bashkia Lezhë të aplikojë masa shtrënguese ndaj subjekteve që prodhojnë mbeturina si dhe subjektit që bën grumbullimin, transportin, përpunimin dhe asgjësimin e tyre, i cili është një faktor që ndikon në cilësinë e gjendjes së mjedisit, trajtuar në faqet 40 - 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

26. Bashkia Lezhë të bashkëveprojë me institucionet e tjera që ligji i ngarkon për mbrojtjen e mjedisit në mënyrë që parandalimi i ndotjes së mjedisit të jetë efektiv dhe eficient, trajtuar në faqet 40 - 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

27. Bashkia Lezhë të marrë masa për rritjen e cilësisë së mjedisit në qytet nëpërmjet hartimit të një strategjie dhe plani për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra për frymë, trajtuar në faqet 40 - 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

28. Bashkia Lezhë të bashkëpunojë me institucionet e tjera shtetërore që ligji i ngarkon në fushën e administrimit dhe mbrojtjen e mjedisit në zbatim të pikës pikës d, neni 11, i ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, trajtuar në faqet 41 - 43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

29. Bashkia Lezhë të hartojë marrëveshje bashkëpunimi me inspektorate, institucione shtetërore, institucione shkencore, organizata jo qeveritare mjedisore, etj. në lidhje me monitorimin e mbrojtjen mjedisit në qytet, trajtuar në faqet 41 - 43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

30. Bashkia Lezhë të bashkëpunojë me ARM, PMNZSH në drejtim të kontrollit dhe marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e normave dhe kushteve teknike, të sigurisë të mbrojtjes nga zjarri në instalimet, në impiantet, në pikat e shitjes sa naftës, gazit të lëngshëm dhe nënprodukteve të tyre si dhe të marrë masa për tu njohur me numrin e saktë të pikave të tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e saj, trajtuar në faqet 41 - 43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

31. Bashkia Lezhë të lidhë aktmarrëveshje me ARM Qarku Lezhë për dërgimin dhe zbatimin e gjobave të vendosura nga ARM, në zbatim të ligjit nr. 7697, datë 07.04.1993 “Për

kundërvajtjet administrative”, neni 19, i ndryshuar me nenin 1, të ligjit nr. 8343, datë 06.05.1998, trajtuar në faqet 41 - 43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Agron Maksutaj, Keida Muça, Ermira Vojka, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHITIT